AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

# KOMUNIKATË PËR MEDIA

## Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2023

03.05.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e Llogarive Qeveritare të Kosovës për periudhën 2015-2023. Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

Gjithsej të hyrat e Qeverisë së Përgjithshme për vitin 2023 ishin 2,860.7 milion Euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, të cilat paraqesin 72% të totalit të të hyrave, tatimet rrjedhëse në të ardhura 16%, pagesat për outputin jo tregtar (shitjet) 4%, ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori tjera të të hyrave.

Gjithsej shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme për vitin 2023 ishin 2,925.5 milion Euro. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë kompensimi i punëtorëve 26%, kontributet sociale dhe përfitimet 24%, formimi i kapitalit bruto 16%, konsumi i ndërmjetëm 15%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategoritë tjera të shpenzimeve.

Ky publikim është përgatitur në përputhje të plotë me Udhëzuesin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Statistikat e Financave Qeveritare (GFSM 2014) dhe sipas Sistemit të Llogarive Evropiane (ESA 2010).

Për më shumë informata lidhur me Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2023, vizitoni: http://ask.rks-gov.net/